

ÇFARË DUHET TË DINI PARA SE TË FILLONI NJË MARRËDHËNIE PUNE?

INFORMACION BAZË MBI MARRËDHËNIET E PUNËS

SI LINDIN MARRËDHËNIET E PUNËS?

Marrëdhëniet e punës mund të fillojnë vetëm në bazë të një marrëveshje midis punëmarrësit dhe punëdhënësit lidhur me vullnetin e lirë të të dyja palëve. Për fillimin e marrëdhënies të punës duhet të nënshkruhet kontrata e punës.

KONTRATA E PUNËS

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Në kontratën e punës, punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.

Kontrata mund të jetë me kohë të pacaktuar apo të caktuar, individuale ose kolektive.

PARA NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS SË PUNËS

Para se të firmosni, sigurohuni që në kontratën e punës të jenë të përfshira qartësisht:

- Pozicioni juaj i punës;
- Kohëzgjatja e kontratës dhe orari i punës;
- Paga mujore (llogarisni me kujdes pagën tuaj mujore neto);
- Përshkrimi i detajuar për kryerjen e punës nga ana juaj;
- Kushtet fizike në të cilat do të kryeni punën;
- Mënyra e kryerjes së pagesës.

KUJDES!

Mos nënshkruani kontratën e punës nëse nuk jeni dakord me të gjitha klauzolat e parashikuara në të!

Kini kujdes nga premtimet që ndryshojnë nga çfarë është është parashikuar në kontratë. Nëse zhvilloni punën tuaj bazuar në premtime, ju jeni i pambrojtur për të kërkuar ligjërisht të drejtat e premtuara!

Ju keni të drejtë të pajiseni me një kopje të kontratës së punës të nënshkruar nga punëdhënësi. Ju keni të drejtë të mos filloni punë deri sa të jeni të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

PUNA ME KOHË TË PJESSHME

Me kontratën e punës me kohë të pjesshme, punëmarrësi pranon të punojë me orë, gjysmë dite pune ose ditë pune, për një kohëzgjatje normale javore ose mujore më të vogël se ajo e punëmarrësve që punojnë me kohë të plotë në të njëjtat kushte.



ORËT SHITESË

Me orë shtesë kuptohet çdo orë pune e kryer mbi kohëzgjatjen ditore normale ose javore maksimale të punës (koha normale e punës është 40 orë në javë).

Orët shtesë të punës mund të kompensohen me pushim ose me pagesë shtesë mbi pagën normale në vlerën jo më pak se 25 për qind të saj.



SHTESA TË TJERA MBI PAGË

Çdo orë pune e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 për qind.

Çdo orë pune e kryer midis intervalit 22:00 dhe 6:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50 për qind.



PUSHIMI JAVOR DHE DITËT E FESTAVE

Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.

Pushimi javor përfshin ditën e diel.

Pushimi javor nuk është i pagueshëm.

Si rregull ndalohet puna në ditët e festave zyrtare.

Punëmarrësi gëzon të drejtën e pagës në ditët e festave zyrtare.



PUSHIMET VJETORE

Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim.

Pushimet vjetore nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare. Nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet.

Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.

Punëdhënësi duke mbajtur parasysh dëshirën e punëmarrësit përcakton datën e fillimit të pushimeve vjetore të paguara. Data e fillimit të pushimeve vjetore i njoftohet punëmarrësit të paktën 30 ditë përpara.

Pushimet vjetore duhet të jepen gjatë vitit të punës ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës.

Pushimet vjetore nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar dhe punëmarrësi nuk i ka kryer pushimet që i takojnë.



SHPËRBLIMI

Nëse palët bien dakord, punëdhënësi i jep punëmarrësit një shpërblim të veçantë mbi pagë, në fund të vitit, duke marrë parasysh cilësinë e punës së tij ose mbarëvajtjen e ndërmarrjes.



KUJDES!

Nëse punoni orë shtesë, shënojinë ato në kohëshënuesin tuaj të punës dhe kërkoni kompensim mbi pagën ose pushim. Kjo është e drejta juaj!

Nëse jeni me pushime vjetore apo në ditët tuaja të pushimit dhe duhet të punoni, kërkoni që t'ju kompensohet kjo kohë që po punoni. Kjo është e drejta juaj!